



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 220 / 5 Prot

Tiranë, më 10/5/2021

VENDIM

Nr. 25, datë 10.5.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 228 Prot., datë 28.01.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet shkresës datë 11.11.2020, depozituar në adresën _____, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- 1- Kopje e të gjitha vendimeve të marra në periudhën 2010 – 2020 me objekt sekuestrimin e pasurive në zbatim të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
- 2- Kopje e të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010-2020 me objekt konfiskimin e pasurive në zbatim të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për

parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;

- 3- *Kopje e të gjitha vendimeve të marra gjatë vitit 2020 me objekt vendosjen e sekuestros në zbatim të Aktit Normativ nr.01, datë 31.01.2020, i miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 05.03.2020;*
- 4- *Kopje e të gjitha vendimeve të marra gjatë vitit 2020 me objekt heqjen/revokimin e sekuestros në zbatim të Aktit Normativ nr.01, datë 31.01.2020, i miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 05.03.2020.*
- 5- *Kopje e vendimeve të marra gjatë vitit 2020 me objekt konfiskimin e pasurive të sekuestruara sipas nenit 23 të Aktit Normativ (nëse ka të tilla).*

Ankuesi me pretendimin se, Autoriteti Publik, ka vendosur në dispozicion informacionin vetëm me të dhëna statistikore për periudhën 2014 – 2019 dhe jo kopje të vendimeve, në kundërshtim kjo me kërkesën për informacion, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 228/1 prot., datë 15.02.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet në lidhje me trajtimin apo procedurën e ndjekur në lidhje me kërkesën për informacion.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 200/1 Prot., datë 22.02.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 228/2 Prot., datë 24.02.2021, ka informuar ndër të tjera se: “*...Informacioni që i është vënë në dispozicion kërkuesit, përmban Vendimet e OFL-ve, Vendimet e Sekuestrimeve dhe të Konfiskimeve, gjithmonë në zbatim të Udhëzimit për Përpunimin, Anonimizimin e të Dhënave Personale dhe Publikimin e tyre në Vendimet Gjyqësore me të dhëna sensitive, sipas shkronjës “c” pika “1, neni 30 dhe shkronja “f” e pikës 1, neni 31 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave presonale”, i ndryshuar. Nga ana tjetër, konstatojmë se në bazë të Udhëzimit për përpunimin, anonimizimit e të dhënave personale, datë 22 janar 2020, i ndryshuar, Komisioneri përcakton rregulla për Mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të dhënave sensitive të Vendimeve Gjyqësore. Ky proces realizohet manualisht dhe kërkon korrigjim, monitorim dhe kohën e nevojshme. Për pasojë, informacioni i dhënë i plotëson kushtet e nevojshme. Këto prpcedura janë bërë sipas ligjit duke marrë gjithë kohën e nevojshme*

për shkak të ngarkesës në punë. Për këto arsye jemi të gatshëm të vijojmë me bashkëpunimin.”

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* si dhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.*

Duke pasur parasysh situatën e krijuar si pasojë e përhapjes së COVID-19 dhe në zbatim të masave të marra nga institucionet përkatëse, seanca dëgjimore u zhvillua nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (on-line/video-call), në datën 16.03.2021, ora 11.40 me prezencën e palëve.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar më sipër.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik, sqaruan ndër të tjera se: *“...nuk ndodhen para faktit të refuzimit të informacionit ndaj ankuesit, i cili sikurse është përmendur edhe më sipër, ka marrë informacion të mjaftueshëm, mbi vendimet e dhëna në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, si dhe vendimet e dhëna nga kjo gjykatë në kuadër të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike”.*

Në lidhje me vendimet e dhëna për sekuestro dhe konfiskim përgjatë periudhës 10-vjeçare, në kuadër të ligjit Antimafia, për shkak të volumit aktual të punës, si dhe në kushtet kur anonimizimi i vendimeve duhet të bëhet manualisht, ka qenë e pamundur vënien në dispozicion të ankuesit e këtyre vendimeve. Me krijimin e GJPKKO-së në 19.12.2019, i është kërkuar KLGJ-së, shtimi në organikën e gjykatës i një punonjësi (sekretari), i cili do të kryente anonimizimin e vendimeve, për t'i publikuar ato në vijim në faqen e web-it të gjykatës. Njëkohësisht vlen të theksohet fakti se në organikën e gjykatës, që nga tetori i vitit 2020, ka munguar specialisti i vetëm i IT, rekrutimi i të cilit dhe stafit të munguar të gjykatës në tërësi, kanë qenë të pamundur deri në miratimin e Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”. Fillimi i rekrutimeve për pozicionet e punës së sipërcituara ka filluar pas miratimit të këtij vendimi”.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur në përputhje me udhëzimin nr.15, datë 23.12.2011 *“Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.* Përfaqësuesit e Autoritetit Publik, pas dakordësisë edhe të ankuesit, siguruan marrjen e masave të nevojshme për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 09.04.2021 ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: “...në përputhje me Udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, konkretisht pikën 4, të Kreut 4, e cila parashikon se: “Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtëm, në mbrojtje të privatësisë:

a) Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen.

b) Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që çënojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave).”

Ankuesi, pas komunikimit, do të vijë sot në gjykatë të tërheqë të gjitha dokumentet”.

Ankuesi, me e-mail-in datë 05.05.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.228/4 Prot., datë 05.05.2021, ka vijuar me ankimin duke pretenduar ndër të tjera se: “Më datë 4 maj 2021, Gjykata e Posaçme ka dërguar kopje të vendimeve për vitet 2013, 2014, 2015, 2017 dhe 2018 të cilat konsiderojmë se nuk janë në formën e duhur pasi rezulton të jenë fshirë emrat e kompanive; vlerat e pasurive; lloji i pasurive; sipërfaqja e pasurive; emërtimet e pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara, si dhe janë anonimizuar emrat e personave të proceduar të cilëve u janë sekuestruar pasuritë. Kopjet e vendimeve të vendosura në dispozicion, ku janë ononimizuar disa lloje të dhënash të rëndësishme, e bëjnë të pakuptueshme përmbajtjen e tyre dhe për këtë arsye e konsiderojmë të papërmbushur detyrimin e këtij autoriteti publik për dërgimin e informacionit dhe dokumenteve që kemi kërkuar bazuar në LDI...”

Bazuar në sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI në të cilën parashikohet se, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Për sa i përket legjitimitit të kërkuarit, Komisioneri thekson se LDI nuk kushtëzon dhënien e informacionit/dokumentacionit të konsideruar publik me paraqitjen nga ana e kërkuarit të arsyeve apo interesit që ka në marrjen e këtij informacioni. Për më tepër, kërkuari/ankuesi është përfaqësues i një organizatë jo-fitimprurëse (BIRN Albania), që ka për qëllim kryesor promovimin e medias të lirë dhe të pavarur, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me korrupsionin, pandëshkueshmërinë, situatën e të drejtave të njeriut, si dhe aktivitetin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe rajon, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik në luftimin e veprimtarive kriminale.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë e cila konsiston në vënien në dispozicion të vendimeve që përmbajnë informacion për sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive të

personave të akuzuar si pjesë e krimit të organizuar, të cilat rrjedhimisht përbëjnë një interes për publikun.

Komisioneri, nga verifikimi i dokumentacionit të anonimizuar, konstaton se anonimizimi i bërë nga Autoriteti Publik është jo në përputhje me rregullimin ligjor në fuqi. Ndryshe nga sa argumenton Autoriteti Publik, se është respektuar Udhëzimi nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, rezulton se janë anonimizuar edhe të dhëna si psh: gjeneralitetet e palëve/aksionarëve, të dhënat e shoqërive tregtare, shumat (vlerat) monetare, etj.

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik duhet të rishikojë anonimizimin e informacionit duke mbajtur në konsideratë Udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, konkretisht pikën 4, të Kreut 4, e cila parashikon se: *“Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtëm, në mbrojtje të privatësisë:*

a) Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen.

b) Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohe publikimi i të dhënave personale që çenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave).”

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 228 Prot., datë 28.01.2021 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 11.11.2020, duke respektuar anonimizimin sipas udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, konkretisht: (1. Kopje e të gjitha vendimeve të marra në periudhën 2010 – 2020 me objekt sekuestrimin e pasurive në zbatim të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”; 2. Kopje e të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010-2020 me objekt konfiskimin e pasurive në zbatim të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”; 3. Kopje e të gjitha vendimeve të marra gjatë vitit 2020 me objekt vendosjen e sekuestros në zbatim të Aktit Normativ nr.01, datë 31.01.2020, i miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 05.03.2020; 4. Kopje e të gjitha vendimeve të marra gjatë vitit 2020 me objekt heqjen/revokimin e sekuestros në zbatim të Aktit Normativ nr.01, datë 31.01.2020, i miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 05.03.2020. 5. Kopje e vendimeve të marra gjatë vitit 2020 me objekt konfiskimin e pasurive të sekuestruara sipas nenit 23 të Aktit Normativ), brenda datës 18.5.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.5.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

